

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

I. MATERIALE KËRKIMORE	1
II. ARTIKUJ KËRKIMORË NGA BANKA TË TJERA QENDRORE	5
III. AKTIVITETE KËRKIMORE	7
IV. LINGJE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA	10

Materiali "Të Rejat shkencore në Bankën e Shqipërisë" paraqet një përmbledhje të punës kërkimore të Bankës së Shqipërisë në harkun kohor të gjashtë muajve. Ky numër pasqyron disa nga punët kërkimore të sapo përfunduara, punët kërkimore në proces, artikujt, si dhe aktivitetet kryesore kërkimore shkencore të zhvilluara nga ekonomistët e Bankës së Shqipërisë, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2019.

Kërkimi shkencor në Bankën e Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe, është orientuar drejt materialeve dhe analizave empirike, duke u fokusuar në tema që kanë të bëjnë me: sjelljen e sektorit bankar, luhatjet e kursit të këmbimit, politikën monetare, si dhe me paratë elektronike. Në mënyrë të përmbledhur, ato paraqiten më poshtë.

1. MATERIALE KËRKIMORE

1.1. MATERIALE KËRKIMORE TË PËRFUNDUARA

"Çfarë i shtyn luhatjet e kursit real të këmbimit Lekë-Euro? Aplikimin e një modeli SVAR (strukturor autoregresiv), të kointegruar për identifikimin e goditjeve", nga Altin Tanku dhe Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve

Studimi synon të vlerësojë ndjeshmërinë e kursit të këmbimit ndaj goditjeve reale dhe monetare në Shqipëri pas tranzicionit. Në veçanti, analiza përqipet të nxjerrë në pah nëse kursi i këmbimit është shkaktar i çrregullimeve në ekonomi apo shërben si "përthithës i goditjeve" që stabilizojnë devijimet nga ekuilibri. Ne mbështetemi në një metodë kointegrimit me vektorë

strukturor autoregresiv (SVAR) me kufizime afatgjata. Ndërsa modeli makroekonomik, bazohet në kornizën teorike të trajtuar nga Weber (1997) me pesë tregues, konkretisht punësimi, rritja ekonomike, kursi real i këmbimit, paraja dhe çmimet. Dy treguesit e parë kanë për qëllim të identifikojnë efektet e shkaktuara nga oferta; i treti identifikon goditjet nga kërkesa reale; ndërsa dy treguesit nominalë synojnë të kapin përkatësisht efektet e kërkesës dhe ofertës për para. Rezultatet sugjerojnë se goditjet monetare shpjegojnë rreth 28% të ecurisë së kursit real të këmbimit në Shqipëri. Ndërkaq, efektet e tyre paraqiten të neglizhueshme në rreth dy vitet e fundit, për rrjedhojë, forcimi i kursit real të lekut mund të burojë më së shumti nga performanca e ekonomisë reale.

Përderisa faktorët realë janë përkufizuar si të "përhershëm", pozicioni i lekut në periudhën e fundit vlerësohet përgjithësisht në përputhje me zhvillimet kryesore ekonomike dhe rreth ekuilibrit të nënkuptuar nga këto zhvillime. Së fundi, shpjegueshmëria e kursit real në pjesën më të madhe nga themelet e ekonomisë reale, siç rezulton nga vlerësimi jonë, favorizon natyrën dhe përshtatshmërinë e regjimit aktual të kursit të lirë të këmbimit.

"Ndikimi dhe ekspozimi ndaj tregut të pasurive të patundshme në sjelljen me rrezik të bankave: Evidencë nga vendet e EQJL-së", nga Elona Dushku (Departamenti i Kërkimeve), Antje Hildebrandt (Banka Qendrore e Austrisë) dhe Erjona Rebi (Departamenti i Politikës Monetare)

Materiali vlerëson empirikisht ndikimin që dinamika dhe ekspozimi ndaj tregut të pasurive të patundshme ka në stabilitetin e sistemit bankar të vendeve të Evropës Qendrore Juglindore (EQJL-së). Gjithashtu, në material analizohet nëse ka diferenca në sjelljen e bankave të vendosura në Evropën Qendrore përkundrejt atyre në Ballkanin Perëndimor. Rezultatet tregojnë që ekspozimi i bankave ndaj tregut të shtëpive ka pasur një ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në stabilitetin e bankave për të dy grupet e vendeve. Ndërsa, në lidhje me ndikimin që dinamika e çmimeve të shtëpive ka në stabilitetin bankar, vlerësimet e marra për dy grupet e vendeve janë të përziera. Rezultatet e përfituara reflektojnë shkallën e ndryshme të zhvillimit të tregut të pasurive të patundshme, të sistemit bankar dhe të zhvillimit institucional të vendeve të marra në analizë.

"Paraja elektronike dhe teknologjia financiare: Një përditësim", nga Bledar Hoda, Departamenti i Kërkimeve

Shumëllojshmëria e produkteve financiare të bazuara në Teknologjinë e Regjistrimit të Decentralizuar të transaksioneve është kategorizuar me emërtimin 'kriptoaktive' nga organizatat standardpërcaktuese, si Bordi i Stabilitetit Financiar (BSF). Kriptoaktivet kanë potencialin të konkurrojnë, sfidojnë ose transformojnë shumë nga produktet dhe shërbimet ekzistuese në industrinë financiare, si edhe të ngrejnë sfida të reja për autoritetet rregullatore. Në këtë material synohet njohja me zhvillimet më të fundit të aktivitetit të bazuar në teknologjitë e reja financiare (FinTek). Materiali prek tre çështje kryesore: (i) zhvillimi dhe potenciali i teknologjive të reja FinTek në sektorin financiar dhe sektorë të tjerë të ekonomisë; (ii) mundësitë e emetimit të parasë elektronike të bankave qendrore (PEBQ); dhe (iii) përjasjet rregullatore aktuale të autoriteteve ndërkombëtare standardpërcaktuese ndaj këtyre risive teknologjike dhe financiare.

1.2. MATERIALE KËRKIMORE NË PROCES

"Vrojtimi mbi financat dhe konsumin e familjeve shqiptare", Elona Dushku dhe Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve

Zhvillimet ekonomike të dekadës së fundit treguan qartësisht se të dhënat në nivel mikro për ndërmarrjet, familjet, bankat, institucionet financiare etj. krijojnë mundësinë për të analizuar në mënyrë më të detajuar dhe më të plotë fenomene të ndryshme ekonomike. Kjo bëri që vëmendja t'i kushtohet pasurimit të të dhënave në nivel mikro për të ndërtuar profile të ndryshme të rrezikut, kryesisht të familjeve bazuar në nivelin e të ardhurave, profesioneve, grup-moshave, aksesit në kreditim, nivelit të pasurisë reale e asaj financiare etj. Banka e Shqipërisë, në funksion të përmbushjes

së objektivit të saj të stabilitetit të çmimeve dhe të stabilitetit financiar, zhvilloi për herë të parë "Vrojtimin mbi Financat dhe Konsumin e Familjeve Shqiptare", mbështetur në pyetësinë e ndërtuar nga Banka Qendrore Evropiane, përshtatur me specifikat e familjeve shqiptare. Vrojtimi u zhvillua në terren nga INSTAT-i gjatë muajve mars-prill 2019, dhe kishte për qëllim mbledhjen e informacionit të 2,500 familjeve shqiptare në lidhje me pasurinë reale dhe financiare të tyre, detyrimet dhe investimet financiare, si dhe shpenzimet dhe të ardhurat e familjes. Zgjedhja e familjeve në të gjithë territorin është bërë në mënyrë rastësore nga INSTAT-i, bazuar në parimin e proporcionalitetit, për të pasur një përfaqësim të plotë të gjithë popullatës së familjeve shqiptare. Vrojtimi mbi financat dhe konsumin e familjeve shqiptare jo vetëm që do të shërbejë për pasurimin e të dhënave në nivel familjeje, por më së shumti do të përmirësojë dhe do të thellojë analizat e Bankës së Shqipërisë mbi sjelljen e familjeve shqiptare në funksion të politikës monetare dhe të stabilitetit financiar.

"Kultura financiare në Shqipëri: Rezultatet e vërtetimit për matjen e nivelit të njohurive financiare të popullatës, 2019", nga Arlinda Koleniço, Kliti Ceca dhe Egnis Isaku, Departamenti i Kërkimeve

Pas vërtetimeve të viteve 2011 dhe 2015, Banka e Shqipërisë do të kryjë për herë të tretë mbledhjen dhe publikimin e të dhënave që lidhen me nivelin e kulturës financiare të popullatës në Shqipëri. Anketa "Kultura Financiare në Shqipëri" bazohet në direktivat dhe metodologjinë e OECD/INFE dhe pritet të zhvillohet në bashkëpunim me INSTAT në muajt shtator-tetor 2019. Në përfundim të këtij anketimi, do të realizohet analiza e treguesve të

grumbulluar, si dhe ajo krahasuese me të dhënat e viteve të mëparshme. Të dhënat e marra nga kjo anketë përbëjnë informacion të rëndësishëm për identifikimin e çështjeve që kanë nevojë për vëmendje dhe ndërhyrje, përmes projekteve të edukimit financiar.

"Parashikimi i inflacionit afatshkurtër në Shqipëri nëpërmjet një modelit VAR Bajesian", nga Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve

Ky projekt synon të pasurojë portofolin e mjeteve parashikuese afatshkurtra të inflacionit të Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet ndërtimit të një modeli VAR Bajesian (BVAR), i cili ndryshe nga modelet standarde me vektorë autoregresive (VAR), adreson çështjen e mbiparametrizimit, duke lejuar përfshirjen e më shumë ndryshoreve endogjene dhe duke mundësuar në këtë mënyrë një shpjegueshmëri më gjithëpërfshirëse të inflacionit. Një sërë modelesh me një ndryshore janë vlerësuar për të parashikuar inflacionin afatshkurtër, të tilla si: mesatarja e pakushtëzuar, ecja e rastësishme dhe ARIMA, ndër të cilët modeli me performancën më të mirë është përzgjedhur si referencë për të vlerësuar performancën parashikuese të modelit BVAR. Në vazhdim, është vlerësuar një model i pakufizuar VAR, si mjeti më i përdorur për të parashikuar treguesit kryesorë ekonomikë, bazuar vetëm në informacionin që ofrojnë seritë e të dhënave. Rezultatet tregojnë se modeli BVAR, i cili përfshin më shumë informacion ekonomik, i tejkalon modelet standarde me një ndryshore dhe modelin VAR në horizonte të ndryshme kohore të mostrës parashikuese. Megjithatë, ndryshimet në performancën parashikuese midis modeleve janë statistikisht të parëndësishme.

“Lidhja midis ndryshimit në papunësi dhe rritjes ekonomike reale në Shqipëri”, nga Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve

Synimi i këtij projekti është të hulumtuarit për llojin e lidhjes që ekziston midis normës së ndryshimit të papunësisë dhe normës së ndryshimit të PBB-së reale në Shqipëri, me qëllim kuptimin e dinamikës së përbashkët të ndryshimit midis këtyre dy treguesve ekonomikë, bazuar në të dhëna tremujore “flow”, të siguruara nga INSTAT.

“Si e ndikon norma repo ekonominë shqiptare. Një analizë VAR mbi mekanizmin e transmissioinit të politikës monetare”, nga Denada Rada, Departamenti i Kërkimeve

Ky studim analizon impaktin e një goditjeje të politikës monetare me anë të përdorimit të repos, si normë interesi afatshkurtër, në PBB, inflacion, agregatin monetar M3, si dhe në kursin e këmbimit Lek/Euro në Shqipëri, duke përdorur të dhënat e periudhës 2002-2018. Duke u bazuar në një model të vektorëve autoregresivë, rezultatet tregojnë se një rritje në normën e interesit afatshkurtër priret të sjellë një ulje në PBB-në, në agregatin monetar M3, në inflacion, si dhe një vlerësim të monedhës vendase. Për më tepër, ky material analizon variacionet në normën e repos, e cila tregon luhatje të ndjeshme në PBB dhe në agregatin monetar, ndërsa shpjegon luhatje të vogla në inflacion dhe në kursin e këmbimit.

“T’u besojmë bankierëve: Analiza e faktorëve të kërkesës dhe ofertës së kanalit të kredisë në rastin e Shqipërisë, bazuar në informacionin nga Vrojtimi i

Aktivitetit Kreditues”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve

Një çështje kyçe është të kuptojmë nëse dhe në çfarë mase kreditimi bankar është rezultat i faktorëve të kërkesës, që ndikohet nga aftësia e firmave dhe e ekonomive familjare për të marrë hua, apo e karakteristikave të bilancit të institucioneve financiare, që shtrëngojnë standardet e ofertës, duke dëmtuar huadhënien bankare. Ky material analizon këtë çështje, duke u mbështetur në informacionin e përfituar nga përgjigjet e “Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues” në nivel vendi, në rastin e Shqipërisë. Në veçanti, dy kanalet e ndryshme të transmetimit identifikohen, duke vëzhguar faktorët që ndikojnë në vendimin e bankave për të ndryshuar kushtet e huadhënies dhe standardet për huamarrësit e tyre, si dhe faktorët që lidhen me aftësinë kreditore të huamarrësit dhe karakteristikat e bilancit të tyre.

“Evidenca mikroekonomike mbi sjelljen çmimpërcaktuese të ekonomisë shqiptare”, nga Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve

Ky material ka për qëllim të analizojë sjelljen e çmimeve në Shqipëri gjatë periudhës 2008-2019, bazuar në llogaritjen e tre treguesve kryesorë: frekuenca, sasia dhe qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve. Materiali përdor të dhënat e dezagreguara të IÇK-së (indeksi i çmimeve të konsumit) dhe përlllogaritje të thjeshta statistikore për të dhënë evidenca rreth ngurtësisë së çmimeve, si dhe heterogjenitetit të sjelljes midis grupeve të ndryshme të shportës së konsumit.

II. ARTIKUJ KËRKIMORË NGA BANKA TË TJERA QENDRORE***“Politika monetare dhe kushtet financiare: Një studim ndër vende”, nga Tobias Adrian, Fernando Duarte, Federico Grinberg dhe Tommaso Mancini-Griffoli, Rezerva Federale e New York-ut***

Kushtet financiare në kahun lehtësues parashikojnë rritje të lartë dhe volatilitet të ulët të prodhimit deri në gjashtë tremujorë në të ardhmen, duke gjeneruar një rrezik për ulje në kohë të hendekut të prodhimit, matur me anë të PBB-së në Rrezik (GaR). Kjo gjetje është e qëndrueshme ndërmjet vendeve, treguesve kushtëzues dhe periudhave kohore. Autorët studiojnë implikimet për politikën monetare në një model Neo-Kejnsianist të reduktuar me ndërmjetës financiarë, që janë subjekt i një kufizimi të Vlerës në Rrezik (VaR). Politika monetare optimale është e varur nga madhësia e rrezikut për poshtë të PBB-së, duke qenë se ndikon vendimin konsum-kursime, nëpërmjet kufizimit Euler, dhe kushtet financiare, nëpërmjet shtrëngimit të kufizimit VaR. Vendimi optimal i politikës monetare shfaq një reagim të dukshëm ndaj zhvendosjes së kushteve financiare për pjesën më të madhe të vendeve që janë pjesë e studimit. Përfitimet për mirëqenien, duke marrë parasysh kushtet financiare, rezultojnë të jenë të ndjeshme.

<https://www.newyorkfed.org/research/staff-reports/sr890.html>

“A duhet të emetojnë bankat qendrore një monedhë digjitale?”, nga Todd Keister, Daniel Sanches, Rezerva Federale e New York-ut

Autorët studiojnë se si prezantimi i një monedhe digjitale të emtuar nga banka qendrore prek normat e interesit, nivelin e

aktivitetit ekonomik dhe mirëqenien në një mjedis ku paraja e bankës qendrore dhe depozitat e bankave private zëvendësojnë njëra-tjetrën. Bankat në model kanë kufizime financiare dhe rreziku shtesë i likuiditetit mbi depozitat bankare ndikon nivelin e investimeve agregate. Autorët studiojnë dizajnim optimal të monedhës digjitale në këto kushte, duke përfshirë nëse paraja duhet apo jo të paguajë interes dhe sa gjerësisht duhet të qarkullojë. Autorët theksojnë se edhe pse një monedhë digjitale ka tendencën të promovojë eficiencë në shkëmbim, ajo mund të shfaq edhe një efekt të reduktimit të depozitave bankare, të rrisë kostot e financimit të bankës dhe të ulë investimet. Pavarësisht këtyre efekteve, prezantimi i një monedhe digjitale të emtuar nga banka qendrore rrit mirëqenien.

<https://www.philadelphiafed.org/-/media/research-and-data/publications/working-papers/2019/wp19-26.pdf>

“Përfitimet dhe kostot e axhustimit të kapitalit bankar: Evidenca nga vendet e Eurozonës”, nga Katarzyna Budnik, Massimiliano Affinito, Gaia Barbic, Saïffedine Ben Hadj, Edouard Chretien, Hans Dewachter, Clara Isabel Gonzalez, Jenny Hu, Lauri Jantunen, Ramona Jimborean, Otso Manninen, Ricardo Martinho, Javier Mencia, Elena Mousarri, Laurynas Naruševičius, Giulio Nicoletti, Michael O’Grady, Selcuk Ozsahin, Ana Regina Pereira, Jairo Rivera-Rozo, Constantinos Trikoupis, Fabrizio Venditti dhe Sofia Velasco, Banka Qendrore Evropiane

Punimi propozon një kuadër për vlerësimin e ndikimit të nivelit të rezervës të kapitalit

në mbarë sistemin dhe në nivel banke. Vlerësimi mbështetet në një model të vektorëve autoregresivë me faktor (factor-augmented vector autoregression (FAVAR), që lidh rregullimet e bankave individuale me dinamikat makroekonomike. Autorët vlerësojnë modelet FAVAR në mënyrë individuale për njëmbëdhjetë ekonomi të Eurozonës dhe identifikojnë goditjet strukturore, të cilat iu lejojnë të diagnostikojnë dobësitë kyçe të sistemeve kombëtare bankare dhe të llogarisin kostot ekonomike afatshkurtra, si pasojë e rritjes së kapitalizimit të bankave. Në këtë kuadër, autorët zhvillojnë një vlerësim të plotë të kosto-përfitimeve të një rritjeje në rezervën e kapitalit. Përfitimet janë të lidhura me përshpejtimin e rimëkëmbjes bankare ndaj goditjeve negative. Kapitalizimi më i lartë i lejon bankat t'u rezistojnë goditjeve negative dhe të moderojnë rënien e kreditimit ndaj ekonomisë reale. Kostot lidhen me kreditimin e përkohshëm dhe humbjet në prodhim, që janë të vlerësuara si në nivel agregat ashtu edhe në atë bankar. Një rritje në raportin e kapitalit vlerësohet se ka një ndryshim të ndjeshëm në kreditim dhe në aktivitetin ekonomik, në varësi të mënyrës se si bankat përshtaten, për shembull, nëpërmjet ndryshimeve në aktive apo në kapital.

<https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/>

“A e ndihmon informaliteti stabilitetin e inflacionit?”, nga Enrique Alberola-Ila dhe Carlos Urrutia, Banka për Rregullime Ndërkombëtare (BIS)

Informaliteti është një karakteristikë e rrënjësor në ekonomitë e vendeve në zhvillim, pavarësisht progresit në menaxhimin makroekonomik të tyre. Informaliteti përcakton sjelljen e tregut të punës, aksesin në financim, si dhe të produktivitetit të ekonomisë në tërësi. Për këto arsye, ai influencon transmetimin

e goditjeve ndër të cilat edhe të politikës monetare. Punimi zhvillon një model të thjeshtë të ekuilibrit të përgjithshëm në një ekonomi të mbyllur me ngurtësi nominale, me fërkime në tregun e punës dhe atë financiar. Informaliteti është pasqyruar nëpërmjet një tregu pune të dyfishtë, ku raporti i të punësuarve informal është endogjen. Vetëm firmat e formalizuara kanë akses në financim, e cila është e rëndësishme për to në procesin e prodhimit. Informaliteti zbut efektet e goditjeve të kërkesës dhe ofertës në çmime; karakteristikat financiare të modelit përkeqësojnë impaktin e goditjeve financiare në tregun formal, ndërkohë që sektori informal mbetet i paprekur në parim. Si rezultat, informaliteti redukton impaktin e goditjeve financiare dhe atyre të kërkesës në paga dhe inflacion, por përkeqëson impaktin e goditjeve teknologjike. Gjithashtu, informaliteti rrit normën e sakrificës së ndërhyrjeve të politikës monetare. Nga këndvështrimi i Bankës Qendrore, rezultatet lënë të kuptohet se prania e një sektori informal zbut volatilitetin e inflacionit për disa lloj goditjesh, por bën politikën monetare më pak efektive.

<https://www.bis.org/publ/work778.htm>

“A mund të shpjegohet inflacioni i ulët nga plakja e fuqisë punëtore?”, nga Benoit Mojon dhe Xavier Ragot, Banka për Rregullime Ndërkombëtare (BIS)

Pse është inflacioni i pagave i ulët pavarësisht uljes së fortë të papunësisë kohët e fundit? Autorët argumentojnë se kjo mund të vijë si pasojë e ndryshimeve në përbërjen e ofertës së punës. Në të vërtetë, norma e pjesëmarrjes së punëtorëve të moshës midis 55 dhe 64 vjeç është rritur ndjeshëm gjatë dekadës së fundit, nga një e treta e forcës punëtore, në më shumë se gjysma, mesatarisht e llogaritur për vendet e OECD-së. Këto vlera kanë më

shumë gjasa të vijë si pasojë e plakjes së popullsisë dhe e reformës së pensioneve. Autorët tregojnë se inflacioni i dobët gjatë 5-vjeçarit të fundit shpjegohet nga pjesëmarrja e lartë e forcës së punës në moshën 55 deri në 64-vjeç. Rezultati i dytë i autorëve është se lidhjet ekonomike

të kurbës së Philips-it vazhdojnë të qëndrojnë. Nëse eksplorohet varianca e vlerave midis vendeve, inflacioni i pagave vazhdon të jetë i ndjeshëm dhe reagues ndaj normës së papunësisë vendase, edhe mbas Recensionit të Madh.

<https://www.bis.org/publ/work776.htm>

III. AKTIVITETE KËRKIMORE

2.1 SEMINARI I SË PREMTE

“Formimi i çmimeve në ekonominë shqiptare: Një përfaqsim makromodeluese”, nga Lorena Skufi dhe Eglent Kika, Departamenti i Politikës Monetare

Materiali paraqet modelimin e bllokut të çmimeve në modelin makroekonometrik të ekonomisë shqiptare (MEAM), duke vlerësuar një grup ekuacionesh që përfshijnë çmimet e ofertës vendase, çmimet e importit, çmimet e kërkesës dhe pagën.

“Analiza dhe zhvillimet strukturore të ekonomisë shqiptare: Përfaqsim sipas matricave të kontabilitetit social”, nga Enian Çela, Iris Metani dhe Evelina Çeliku, Departamenti i Politikës Monetare

Materiali përfshin një pasqyrë të detajuar të strukturës së përgjithshme të ekonomisë shqiptare dhe dinamikave të saj në vite. Në pjesën më të madhe, analiza bazohet mbi statistikat e llogarive kombëtare, që lidhen me Tabelat e Burimeve, të Përdorimeve dhe Input-Output.

“Sjellja e kujdesshme e bankave. Një analizë statistikore sipas metodës së analizës së komponentit kryesor”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve
Ky material analizon faktorin që ndikon

kryesisht në sjelljen e kujdesshme të bankave. Qëllimi është të kuptohet nëse sjellja e kujdesshme e bankave është më shumë një çështje e kufizimeve të imponuara nga rregullimi apo pasojë e vendimmarrjes bankare. Për këtë arsye, së pari, identifikohen një sërë treguesish të ndërlidhur që kanë të bëjnë si me qasjen diskrecionare, ashtu edhe me atë jodiskrecionare të sjelljes së kujdesshme të bankave, përveç provigjionimit të humbjeve nga huatë ose fondet rezervë. Më pas, përdoret analiza e komponentit kryesor për të identifikuar një tregues të ri, komponentin kryesor, i cili është një kombinim linear i treguesve origjinalë, të cilit i referohemi si një tregues optimal për matjen e sjelljes së kujdesshme të bankës. Në përfundim, ky komponent përdoret për të vlerësuar ngjashmëritë dhe dallimet me grupin e informacionit të përdorur për të vlerësuar këtë tregues, për të kuptuar nëse sjellja e kujdesshme e bankave është më shumë çështje e kufizimeve të vendosura nga rregullimi apo pasojë e vetë vendimmarrjes bankare.

“Monedhat virtuale, risitë teknologjike dhe bankingu qendror”, nga Natasha Ahmetaj (Zëvendësguvernatore e II-të, Banka e Shqipërisë) dhe Bledar Hoda (Departamenti i Kërkimeve)

Infrastruktura digjitale që mundëson kryerjen

e pagesave me "Bitcoin" ka zgjuar interesin e autoriteteve monetare. Në këtë seminar u prezantua infrastruktura e Bitcoin, si dhe sfidat dhe mundësitë që përfshirja në treg e kësaj monedhe dhe teknologjisë së saj krijon për politikën e bankave qendrore.

"Një vlerësim i normës natyrore të interesit në Shqipëri", nga Eglent Kika dhe Olti Mitre, Departamenti i Politikës Monetare

Ky material paraqet një vlerësim të normës natyrore të interesit në Shqipëri, duke përdorur teknikën Bajeziane të maksimizimit të funksionit të përgjasisë dhe të filtrit Kalman. Struktura e modelit të përdorur për identifikimin e normës natyrore të interesit bazohet në punimin e Laubach dhe Williams (2003) dhe përfshin një vlerësim të njëkohshëm të hendekut të prodhimit dhe të rritjes së PBB-së potenciale.

"Çfarë i shtyn luhatjet e kursit të këmbimit Lekë - Euro?", nga Altin Tanku dhe Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve

Studimi përpiket t'i japë përgjigje pyetjes nëse kursi i këmbimit shërben si "përthithës i goditjeve", që stabilizon devijimet nga ekuilibri, apo si shkaktar i çrregullimeve në ekonomi. Analiza mbështetet në metodën e vlerësimit me Vektorë Strukturore Autoregresivë (SVAR), ku fillimisht është vlerësuar një model i vogël sipas Clarida dhe Gali (1994) me tre tregues – rritja ekonomike, kursi real dhe inflacioni.

"Efekti i goditjeve neto të të ardhurave në sjelljen e firmave: Një përjasje e dekompozimit të variancës ndaj të dhënave në nivel të firmave", nga Indrit Hoxha, Asistent Profesor i Ekonomisë në

Universitetin Penn State Harrisburg) dhe Edward Hoang (University of Colorado, Colorado Springs)

Në këtë material, autorët aplikojnë një metodologji të dekompozimit të variancës për të përcaktuar sasinë e butësisë së pagesave të korporatave. Ata gjejnë se firmat përdorin borxhin dhe investimet për të zbutur një pjesë të madhe të goditjeve ndaj të ardhurave neto për të mbajtur pagesa më pak të ndryshueshme. Në mënyrë të veçantë, rezultatet empirike tregojnë se firmat e mbajnë rritjen e pagesave të dividendëve relativisht të vogël dhe të qëndrueshme me kalimin e kohës. Për më tepër, gjetjet mbështesin literaturën teorike që tregon se dinamika e politikës së investimeve dhe borxhit duhet të modelohet bashkërisht me politikën e pagimit të dividendëve.

"Llogaritë sektoriale dhe bilancet: Përdorimi i politikave të llogarive sektoriale", nga John Joyce, Ekspert, Fondi Monetar Ndërkombëtar

Prezantimi kishte si qëllim dhënien e një panorame të përgjithshme mbi llogaritë sektoriale, si dhe rëndësinë që kanë të dhënat për bankën qendrore dhe për dizenjimin e politikave të saj. Në seminar u argumentuan përfitimet që vijnë nga përdorimi i llogarive sektoriale në analiza më të plota ekonomike dhe financiare, në funksion të vendimmarrjes së bankave qendrore. Më konkretisht, përdorimi i llogarive sektoriale ndihmon në një analizim më të detajuar dhe të thellë të sjelljes financiare të familjeve, të qeverisë, ndërlidhjet financiare të ekonomisë dhe sektorë të veçantë të ekonomisë me pjesën tjetër të botës, si dhe në një identifikim më të plotë dhe të shpejtë të dobësive financiare dhe të ndikimit të goditjeve në ekonomi, mospërputhjet në bilancin e ekonomisë etj.

2.2 PREZANTIME TË PUNËS KËRKIMORE

Pjesëmarrje e Departamentit të Kërkimeve në konferencën me temë: “Rimëkëmbja financiare dhe rreziku sistematik” 30-31 janar 2019, organizuar nga LSE/IGA, në Londër

Konferenca kishte si qëllim të diskutonte, analizonte dhe vlerësonte aftësinë dhe potencialin e sistemeve financiare për t’i rezistuar krizave të mundshme në të ardhmen dhe kapacitetin për t’u rimëkëmbur shpejt prej tyre. Konferenca analizoi gjithashtu aftësinë e sistemit financiar për të shqyrtuar dhe vlerësuar rrezikun dhe për të përballuar goditjet. Për këtë qëllim, diskutimi u përmbledh në shtatë panele të veçanta dhe tre leksione publike nga personalitete të njohura të ekonomisë e financës. Konkretisht, leksionet u mbajtën nga Michael Bordo, Jacques de Larosière dhe Vito Tanzi. Banka e Shqipërisë u përfaqësua në këtë aktivitet nga Altin Tanku, Departamenti i Kërkimeve.

“Banka e Shqipërisë dhe ndikimi i saj në politikat e kredisë”, nga Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve, prezantuar në konferencën me temë: “Bankat dhe territori shqiptar: Vëzhgimet financiare”, 24 maj 2019, Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

Materiali kishte si qëllim prezantimin mbi objektivat, misionin dhe rolin e Bankës e Shqipërisë, në funksion të stabilitetit të çmimeve dhe të stabilitetit financiar të vendit. Fillimisht, mbas dhënies së një pamjeje të përgjithshme mbi zhvillimet makroekonomike në vend dhe mbi ecurinë e sistemit bankar, u prezantua politika monetare e Bankës së Shqipërisë, sidomos mbas krizës financiare globale, teçjimi i saj në ekonomi, si dhe u paraqitën disa

nga sfidat me të cilat përballet Banka e Shqipërisë, në funksion të realizimit të objektivave të saj.

“A e ndikon konkurrenca stabilitetin bankar pas krizës financiare globale? Evidenca nga Sistemi Bankar Shqiptar”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve, në Workshop-in kërkimor mbi Ekonominë e Ballkanit Perëndimor, më 24-25 qershor 2019, organizuar nga LSE/IGA në Londër

Ky aktivitet kishte për qëllim diskutimin dhe shkëmbimin e ideve midis pjesëmarrësve në lidhje me tematikat kryesore të kërkimit shkencor që vendet po ndërmarrin. Në këtë aktivitet morën pjesë kërkues nga vende të ndryshme të Ballkanit Perëndimor, të cilët patën mundësinë të prezantojnë punimet e tyre teorike dhe empirike në të gjithë fushat e ekonomisë. Banka e Shqipërisë u përfaqësua nga Gerti Shijaku, (Departamenti i Kërkimeve), i cili u pranua për të prezantuar materialin me temë “A ndikon konkurrenca stabilitetin bankar pas krizës financiare globale? Evidencë nga sistemi bankar shqiptar”.

“Programi i asistencës dypalëshe për ngritjen e kapaciteteve për bankat qendrore”

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Programin e Asistencës Dypalëshe për Ngritjen e Kapaciteteve për Bankat Qendrore (BCC), znj. Meri Papavangjeli (Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë) mori pjesë në programin vizitues në Institutin IHEID në Gjenevë, përgjatë një semestri. Nën mbikëqyrjen e profesorit, z. Ugo Panizza, ajo punoi mbi një projekt kërkimor me titull “Parashikimi i inflacionit afatshkurtër në Shqipëri nëpërmjet

një modeli VAR Bajesian”, i cili synon të kontribuojë në pasurimin e portofolit të mjeteve parashikuese afatshkurtra të inflacionit që Banka e Shqipërisë zotëron. Përveç projektit, gjatë kësaj periudhe, punonjësja ndoqi disa kurse si: “Kursi i

Avancuar i Ekonometrisë” në Universitetin e Gjenevës, “Ekonometri”, “Makroekonomi” në IHEID, si dhe aktivitete të tjera, shumë të dobishme dhe efektive për përsëritjen dhe thellimin e mëtejshëm të njohurive mbi fushat kryesore ekonomike.

IV. LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA:

Banca d'Italia

<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>

Bank of Canada

<http://www.bankofcanada.ca/research/>

Banco de Espana

<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>

Bank of England

<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>

Bank of Finland

http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm

Bank of Greece

<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>

BIS Central Bank Research Hub

<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>

Czech National Bank

<http://www.cnb.cz/en/research/>

Deutsche Bundesbank

http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php

European Central Bank

http://www.ecb.int/home/html/researcher_en.html

Federal Reserve

<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>

International Journal of Central Banking

<http://www.ijcb.org/>

National Bureau of Economic Research

<http://www.nber.org/>

International Monetary Fund

<http://www.imf.org/external/pubind.htm>

Oesterreichische Nationalbank

http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp

